



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.2, datë 07.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “NERVIT” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Nervit”, sipas Miratimit Paraparak me Nr. 13802/3, datë 28.12.2018 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Skorovati”, në përroin e Qinamit, degë e lumit të Vodices, me derdhje në lumin Osum, pranë fshatit Qinami, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë”, si dhe shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së miratimit paraparak për hidrocentral “Skorovati” me anë të shkresës me Nr. 4630/1 Prot., datë 20.09.2022 “Për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Miratimit Paraparak për hidrocentral “Skorovati”. për shoqërinë “Nervit”.
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:  
**HEC Skorovati**
  - Prodhimi vjetor i parashikuar: 5.250.000 kwh/vit
  - Fuqia e instaluar: 1.500 kwh
  - Vlera totale e investimit: 191,439,493 lekë pa TVSH.

Vendndodhja e veprës së marrjes/ burimi ujq Përroi i Vallamarës

- $X=564023.5$ ;  $Y=4473082.3$ ;  $Z=1380$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse:  $0.44 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore:  $0.21 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë:  $0.187 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike:  $0.03 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=558083.92$ ;  $Y=4473162.22$ ;  $Z=985$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet:  $0.44 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBV SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

